

Strategjia e Shoqërisë Civile dhe Programi i Përbashkët Strategjik

për Mirëqeverisje dhe Antikorrupsion
në Evropën Juglindore 2020

seldi.net





Strategjia e Shoqërisë Civile dhe Programi i Përbashkët Strategjik

për Mirëqeverisje dhe Antikorrupsion
në Evropën Juglindore 2020

SELDI është nisma më e gjerë vendase për antikorrupsionin dhe mirëqeverisjen e OSHC-ve në Evropën Juglindore. Kjo është një nismë e hapur, që ka për qëllim forcimin e shoqërisë civile në EJT dhe përmirësimin e aftësive për t'u angazhuar me hartuesit e politikave dhe palë të tjera të interesuara për të bërë të mundur që zëri i qytetarëve të dëgjohej në debate politikash mbi qeverisjen e mirë dhe antikorrupsionin në Evropën Juglindore. Strategjia e Shoqërisë Civile dhe Programi i Përbashkët Strategjik për Mirëqeverisje dhe Antikorrupsion në EJT 2020 përshkruan rolin aktual dhe atë të shpresuar në të ardhmen të shoqërisë civile në rajonin e Evropës Juglindore në zbatimin e masave antikorrupsion. Ajo është rezultat i një procesi konsultimi mes anëtarëve të koalicionit SELDI dhe palëve të interesuara në rajon, duke përfshirë OSHC-të e tjera, institucionet qeveritare dhe organizatat rajonale. Ajo ka për qëllim të paraqesë një strategji më të gjerë për shoqërinë civile në Evropën Juglindore në antikorrupsion dhe po ashtu programin e SELDI-t deri në vitin 2020. Ajo siguron lidhjen me Strategjinë e Evropës Juglindore 2020.

Anëtarët e koalicionit SELDI dhe partnerët e asociuar
Qendra për Studimin e Demokracisë, Bullgari (Sekretariati i SELDI-t)
Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), Shqipëri
Shtëpia e Evropës (HoE), Shqipëri
Qendra për Raportim Investigativ (CIN), Bosnje Hercegovinë
Partneriteti për Zhvillimin Social (PSD), Kroaci
INSTITUTI RIINVEST, Kosovë
“Syri i Vizionit”, Kosovë
Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCIC), Republika e Maqedonisë
Instituti për Demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSCS), Republika e Maqedonisë
Instituti i Ohrit për Strategji Ekonomike dhe Çështje Ndërkombëtare, Republika e Maqedonisë
Qendra për Tranzicion Demokratik, Mali i Zi
Instituti Alternativ (IA), Mali i Zi
Qendra për Studime Liberal-Demokratike (CLDS), Serbi
Forumi për Veprim Qytetar FORCA Pozega, Serbi
Fondacioni Turk për Studime Ekonomike dhe Sociale, Turqi
Fondacioni Turk për Studime Ekonomike (TEPAV), Turqi

Instituti Shqiptar i Medias (AMI), Shqipëri
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Shqipëri
Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në B&H, Bosnje Hercegovinë
Sekretariati i Iniciativës Rajonale Antikorrupsion (RAI), Bosnje Hercegovinë
Instituti i Financës Publike, Kroaci
Lëvizja Fol, Kosovë
Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet – ÇOHU!, Kosovë
Qendra për Analizën dhe Parandalimin e Korrupsionit (CAPC), Moldavi
Rrjeti për Afirmimin e Sektorit të OJQ-ve – MANS, Mali i Zi
Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë, Serbi
Qendra e Edukimit - Krusevac, Serbi
Proaktiv, Serbi



Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e iniciativës së SELDI-it dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si pikëpamje të Bashkimit Evropian.

ISBN: 978-954-477-288-8

© 2016, Liderhsipi i Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet (SELDI)
Creative Commons License
Attribution-NonCommercial-NoDerivs 3.0 Unported
Qendra për Studimin e Demokracisë
Rruga “Alexander Zhendov”, 5, 1113 Sofia
tel.: (+359 2) 971 3000 fax: (+359 2) 971 2233
csd@online.bg, www.csd.bg

TABELA E PËRMBAJTJES

KAPITULLI 1. SFIDAT AKTUALE TË KORRUPSIONIT DHE ROLI I OSHC-VE	5
1.1. Sfidat aktuale të korrupsionit	5
1.2. Roli i OSHC-ve dhe iniciativës SELDI	5
1.3. Përfshirja me nismat ndërkombëtare dhe evropiane	6
1.4. Rekomandimet kryesore	7
KAPITULLI 2. RITJJA E AFTËSIVE TË PËRGJITHSHME TË OSHC-VE NË RAJON	9
KAPITULLI 3. KAPITULLI 3. PËRFORCIMI I KAPACITETEVE TË OSHC-VE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN	11
3.1. Bashkëpunimi mes OSHC-ve dhe Politikëbërësve	11
3.2. Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe legjitimitetit të OSHC-ve	12
3.3. Sinergjitë dhe bashkëpunimi midis OSHC-ve	13
3.4. Të punosh me gazetarë investigativë dhe të kesh një prani të suksesshme në mediat sociale	13
KAPITULLI 4. Tabela e Qëndrueshmërisë dhe Planifikimit Strategjik në vitin 2020	16

KAPITULLI 1. SFIDAT AKTUALE TË KORRUPSIONIT DHE ROLI I OSHC-VE

1.1. SFIDAT AKTUALE TË KORRUPSIONIT

Pavarësisht disa arritjeve të rëndësishme, më së shumti të lidhura me stabilizimin e institucioneve demokratike, miratimin e ligjeve në fushat kryesore antikorrupsion, një reduktim në rryshfetet e vogla dhe rritje të intolerancës publike ndaj korrupsionit, reformat e mirëqeverisjes dhe antikorrupsion nuk janë konsoliduar, korrupsioni në mesin e politikanëve dhe gjyqtarëve të zgjedhur duket se është në rritje dhe zbatimi i legjislacionit antikorrupsion është arbitrar.¹ Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit të SELDI-t ka treguar se ka pasur progres të vazhdueshëm, por të pabarabartë në trajtimin e korrupsionit administrativ në nivelet e ulëta në rajon në vitet 2001-2016. Megjithatë disa vende kanë përkeqësuar rezultatet e tyre në vitin 2016 në krahasim me vitin 2014. Çështja kyçe e antikorrupsionit në rajon mbetet korrupsioni në nivele të larta dhe kapja e shtetit siç dëshmohet nga mungesa e hetimeve pa përndjekje efektive të korrupsionit politik.² Kjo minon funksionet themelore të institucioneve demokratike, të tilla si ndarja e kompetencave. Institucionet e specializuara kombëtare antikorrupsion luftojnë për të kombinuar funksionet parandaluese dhe represive. Organet ligjvënëse dhe parlamentet në rajon nuk rankohen mirë kur është fjala për besimin publik. Kodet e sjelljes etike janë të rralla dhe të pazbatuara; lobimi për kuadrin rregullator është edhe më i rrallë. Vetëm kohët e fundit kanë filluar të prezantohen procedurat për heqjen e imunitetit nga ndjekja penale, megjithëse me një mungesë kurajoje dhe besimi; kudo ku ekziston një organ i antikorrupsionit në parlament, ai është në mënyrë tipike për të mbikëqyrur disa agjenci ekzekutive, dhe jo për tu marrë me korrupsionin mes deputetëve. Kultura e mbajtjes nën "kontroll" të organeve të administratës publike në vend të menaxhimit të punës nëpërmjet instrumenteve të bazuara në motivim është ajo që pengon si përmirësimin e një shërbimi civil profesional, ashtu edhe reduktimin e korrupsionit. Në të gjitha vendet e rajonit, ekonomitë e fshehta janë të një madhësie të konsiderueshme, duke konfirmuar hendekun e gjerë mes institucioneve formale dhe informale. Kjo krijon një rreth vicioz me para të korrupsionit duke fituar avantazh të padrejtë në treg dhe duke zvarritur zhvillimin ekonomik, siç është dëshmuar nga boshllëku i madh në të ardhura, punësim dhe varfëri në Evropë. Mungesa e gjetjes së mundësive në vendin e tyre, i ka bërë njerëzit në rajon të votojnë duke u larguar drejt Evropës me ritme shumë të shpejta.

1.2. ROLI I OSHC-VE DHE INICIATIVËS SELDI

Reduktimi i korrupsionit kërkon masa përkatëse për ndërtimin e institucioneve dhe krijimin e parakushteve sociale për vendosjen e shtetit ligjor. Në këtë kontekst, OSHC-të në rajon mund të kontribuojnë në krijimin e këtij trekëndëshi përmes përpjekjeve të tyre në gjetjen e një platformë të përbashkët me politikanë reformistë lokalë dhe institucione shtetërore dhe rajonale, palë të interesuara evropiane dhe ndërkombëtare, për të punuar në monitorimin e antikorrupsionit, parandalimin dhe ndjekjen penale. Kjo është një detyrë e frikshme për OSHC-të në një rajon të shtrënguar nga financat publike, me kapacitet dhe iniciativë të ulët të sektorit privat. Përveç kësaj, qeveritë dhe grupet radikale politike vendase janë bërë gjithnjë e më të ashpër në etiketimin e OSHC-ve, të cilat marrin fonde kryesisht nga SHBA-të, por edhe në disa raste edhe nga donatorë Evropianë,

¹ SELDI, Center for the Study of Democracy, (2015). *Anticorruption Reloaded: Assessment of Southeast Europe*

² SELDI, Center for the Study of Democracy (2016). *Shadow Power: Assessment of Corruption and Hidden Economy in Southeast Europe.*

si agjentë të ndikimit të huaj, me synim reduktimin e kapaciteteve të tyre ndikuese. Një mënyrë për të kapërcyer këtë armiqtësi vendore është angazhimi në veprime të përbashkëta ndërshtetërore dhe në shkëmbimin e njohurive në mirëqeverisje dhe antikorrupsion. Iniciativat si Lidërshtetërore për Zhvillim dhe Integritet (SELDI) mbledhin OSHC-të udhëheqëse në këtë fushë për të ndihmuar në ndërtimin e mundësive të reja ose forcimin e atyre ekzistuese për përmirësimin e qeverisjes dhe antikorrupsionit. Perspektiva e anëtarësimit në Bashkimin Evropian ka krijuar një kuadër të përgjithshëm politik të favorshëm për adresimin e korrupsionit në Evropën Juglindore. Një përfundim i rëndësishëm i përbashkët i marrë nga zbatimi i projekteve të bashkëfinancuara të BE-së për mbështetjen e krijimit të rrjeteve të OSHC-ve në Evropën Juglindore është se presioni dhe financimi ndërkombëtar duhet të plotësohet nga platformat dinamike vendore të OSHC-ve, të cilat kanë dëshmuar të jenë të afta për të realizuar monitorim të vazhdueshëm të zhvillimeve të brendshme, për të rritur ndërgjegjësimin për çështje me interes, për të mësuar nga kolegët e rajonit dhe për të krijuar koalicione të përbëra nga palë qeveritare, jo-qeveritare, sektori privat dhe partnerë ndërkombëtarë për të vepruar në çështje specifike.³ Strategjia e tanishme ka për qëllim të përcaktojë parimet e funksionimit të platformave të tilla të qeverisjes së mirë dhe antikorrupsionit në Evropën Juglindore, duke përdorur si një hap themelor përpjekjet dhe rezultatet e mëparshme të Nismës për Zhvillimin Ligjor të Evropës Juglindore (SELDI) në vitin 2001 - 2002 dhe duke marrë në konsideratë përpjekjet për të transformuar Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal me Iniciativën e saj Rajonale Antikorrupsion. SELDI ka për qëllim të shërbejë si shembull i një platforme rajonale të shoqërisë civile vendase dhe të hapur, për antikorrupsionin dhe qeverisjen të mirë, duke marrë shkas si nga përpjekjet vendore dhe të bazës të shoqërisë civile ashtu edhe nga nismat e qeverive të rajonit të tilla si Strategjia e EJL-së 2020 e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Strategjia e EJL-së 2020 bën thirrje për mbështetje në rregulla dhe jo në diskrecion për luftimin e rryshfetit, për prokurim publik konkurrues dhe të standardizuar, dhe ndërtim të kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit. SELDI angazhohet me qeveritë e EJL-së dhe aktorëve të tjerë për zhvillimin e mëtejshëm të reformave të mirëqeverisjes në rajon. Në vitet 2012 - 2016 SELDI ka fituar mirënjohje si një organizatë cilësore si në mendime ashtu edhe në veprime për përpjekjet e saj në rajon dhe në Evropë duke krijuar themelet për një punë më aktive në avokim në të ardhmen.

1.3. PËRFSHIRJA ME NISMAT NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE

Iniciativat e OSHC-ve të Evropës Juglindore, duke përfshirë edhe SELDI-n, si dhe qytetarët, mund të kontribuojnë në debatin politik për mirëqeverisje dhe antikorrupsion në Evropën Juglindore dhe në nivel të BE-së në forma të ndryshme. Për shembull, ata mund të ofrojnë rekomandime dhe komente në raportet e procesit të integritetit në BE (kapitujt 23 dhe 24) ose të kryejë monitorimin e procesit të zbatimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit - UNCAC (shih [Using the UN Convention against Corruption to Advance Anti-corruption Efforts: A Guide](#)). Ata gjithashtu mund t'i bashkohen nismave nën Shtyllën e Qeverisjes së Strategjisë së EJL-së 2020 ose të punojnë me aktorë të tjerë ndërkombëtarë aktivë në rajon, të tillë si UNODC, UNDP, OSBE, etj.

³ SELDI, (2013). SELDI Strategy and Action Agenda for Good Governance and Anticorruption in Southeast Europe

Vëmendje e veçantë duhet t'i jepet bashkëpunimeve ndërkombëtare. Duke pasur parasysh disa qëndrime ekstreme partiake ndaj politikës së brendshme, angazhimet ndërkombëtare mund të lehtësojnë adoptimin e politikave reformuese, të cilat në të kundërtën mund të ishin shmangur nga politikanët kombëtarë. Raportet e progresit të Komisionit Evropian, financimi i BE-së për reforma dhe marrëveshjet e binjakëzimit janë instrumente të rëndësishme ndërkombëtare për agjendat kombëtare antikorrupsion në vendet e Evropës Juglindore. Megjithatë përfshirja ndërkombëtare gjithashtu ka kontribuar për rrezikun e shkëputjes nga realitetet vendase, pritshmëritë jorealiste për rregullime të shpejta, të cilat nga ana tjetër mund të sjellin adoptimin sipërfaqësor të masave ad-hoc. Kjo është përkeqësuar edhe më tej nga preferenca natyrore e BE-së ndaj përjasjes qeveri-qeveri, e cila shpesh krijon një rrugëtim reformash paralele, por të veçantë me punën e OSHC-ve. Angazhimi me partnerët ndërkombëtarë të politikanëve dhe partive reformiste ka nevojë të mbështetet, dhe të pranohet nga shoqëria civile në trekëndëshin e bashkëpunimit.

1.4. REKOMANDIMET KRYESORE

Përvoja e vendeve të SELDI-t në luftën e korrupsionit që nga viti 2001 tregon se zgjidhja e sfidës së korrupsionit në rajon do të kërkojë përpjekje të qëndrueshme nga shumë fronte. Raportet Rajonale të Antikorrupsionit të SELDI-t sigurojnë një numër rekomandimesh për të arritur progres të mëtijshëm në kufizimin e korrupsionit, duke ndikuar në ekonominë e fshehtë dhe krimin e organizuar për të zhbllokuar zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien. Ndërkohë që kompleksiteti i çështjeve të mirëqeverisjes kërkon një qasje gjithëpërfshirëse në shumë fusha të ndryshme, përvoja e SELDI-t në periudhën 2012 - 2016, tregon se tre çështjet kyçe duhet të jenë prioritet në vendet në rajon dhe në nivel evropian, në mënyrë që të arrihet përparim në periudhën afatmesme:

1. Ndjekja penale efektive e politikanëve të nivelit të lartë dhe shërbyesve të lartë civil të korruptuar. Asnjë vend nuk ka qenë në gjendje të thyejë rrethin vicioz të korrupsionit pa demonstruar përparim të qëndrueshëm dhe koherent në këtë drejtim gjatë të paktën tri cikleve politike katër vjeçare.

2. Një mekanizëm monitorimi i pavarur i korrupsionit dhe antikorrupsionit në nivel kombëtar dhe rajonal për të siguruar të dhëna të fuqishme dhe analiza të qëndrueshme për të integruar si diagnostifikimin e korrupsionit edhe vlerësimin e politikave dhe rekomandimeve antikorrupsion. Është e rëndësishme që një mekanizëm i tillë të dorëzohet nga shoqëria civile në bashkëpunim dhe me pranimin e autoriteteve publike.

3. Sektorët kritikë me rreziqe të larta të korrupsionit dhe kapjes së shtetit (të tillë si sektori i energjisë, prokurimi publik, menaxhimi ndërmarrjeve shtetërore, doganat, policia, prokuroria dhe gjykatata, strukturat tatiimore dhe të të ardhurave, si dhe strukturat rregullatore) duhet të trajtohen me prioritet.

KAPITULLI 2. RRIJJA E AFTËSIVE TË PËRGJITHSHME TË OSHC-VE NË RAJON

Organizatat joqeveritare në Evropën Juglindore janë ndër forcat më të rëndësishme drejtuese për antikorrupsionin. Nuk është e pazakontë për organizata think-tank të hartojnë ligje, për ambientalistët të sfidojnë në mënyrë efektive institucionet e kapura ose për vëzhguesit/"watchdogs" të katalizojnë/të menaxhojnë vendosjen e rregullave të reja të transparencës në burokraci të shtetërore.⁴ Në EJT ato janë, megjithatë, larg nga përkthimi i kërkesave të publikut në advokim efektiv për politika, dhe me përballjen me korrupsionin për shkak të një sërë të metave.

Edhe pse OSHC-të në rajon kanë arritur të krijojnë një sërë partneritetesh ndërkombëtare publiko-privat, këto nuk janë përkthyer gjithmonë në partneritete të brendshme. Për shembull, pavarësisht nga fakti se shoqëria civile konsultohet zyrtarisht kur prezantohen projektligje dhe strategji, nuk ka asnjë angazhim thelbësor për të përfshirë shoqërinë civile si një aktor jetik në proces.⁵ Mbështetja e tepërt të ndërkombëtarët, duke përfshirë financimet evropiane, si dhe mungesa e politikave kombëtare për të edukuar sektorët vibrantë të qytetarisë në Evropën Juglindore, rrezikon ndikimin e qëndrueshëm dhe krijimin e kampionëve vendas antikorrupsion.

OSHC-të në rajon përballen me një grup të ngjashëm mungesash në kapacitete dhe problemesh në zhvillimin e tyre, të tilla si:

- Burime njerëzore të papërshtatshme;
- Dobësi financiare;
- Menaxhim dhe planifikim strategjik të dobët;
- Mungesë informacioni mbi politikat kombëtare;
- Nivele të ulëta të kapaciteteve analitike;
- Nivele të ulëta të njohurive në përdorimin e instrumenteve teknike të dobishme për monitorim dhe/ose analiza;
- Mbështetje e dobët publike dhe elektorale;
- Rrjete joefektive dhe të paqëndrueshme.⁶

Qeverisja e mirë nuk është një ushtrim teknik, por kërkon një klimë besimi dhe përgjegjësi qytetare dhe politike në nivel kombëtar, pikërisht çështje këto në të cilat OSHC-të kanë më shumë për të kontribuar. Prandaj, ekziston nevoja për të rritur aftësitë e OSHC-ve për të shërbyer si vëzhgues dhe për të angazhuar qeverinë në reformat antikorrupsion. Kjo përfshin aftësitë për të mbledhur dhe bashkuar informacione primare për funksionimin e institucioneve qeveritare, për të rritur aftësitë e OSHC-ve në mbledhjen, përmbledhjen dhe matjen e gjendjes aktuale të korrupsionit në mënyrë empirike, dhe me anë të analizës së të dhënave, të angazhohen në vlerësimin institucional dhe formulimin e raporteve të politikave.

Ekziston gjithashtu një nevojë për integrim më të mirë të rrjeteve vendase në rajon me partnerët e BE-së, duke përfshirë edhe hapësirën për qasje në të njëjtat mjete financiare. Vendet jo anëtare të BE-së në Evropën Juglindore janë këshilluar të mësojnë nga njohuritë dhe ekspertiza që gjendet në politikat dhe praktikat e

⁴ Qendra për Studimin e Demokracisë. (2010). Shoqëria Civile në Bullgari: Trendet and Risqet, fq 24.

⁵

⁶ Kapacitetet e Organizatave të Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi: një Përmbledhje krahasuese e të tetë vendeve a Comparative Summary of the Eight Country CSO Needs Assessment, Sterland, B., Rizova, TACSO, October 2010.

brendshme të BE-së, të tilla si Raporti i Antikorrupsionit të BE-së. Në mënyrë që të kenë besueshmëri në punën e tyre antikorrupsion, OSHC-të në Evropën Juglindore duhet të japin një shembull të transparencës dhe llogaridhënies. Kjo nënkupton një bindje të rreptë ndaj parimeve të konflikteve të interesit, duke siguruar vetë-rregullimin e tyre, duke kaluar nëpër auditime të rregullta, duke publikuar pasqyrat financiare, duke zbatuar procedura të qarta dhe transparente të qeverisjes korporatave, dhe duke zbatuar masa kundër kapjes nga interesa të veçanta.

Financimi dhe mjedisi ligjor në të cilin OSHC-të në EJT veprojnë duhet të përmirësohet në lidhje me (a) Rregullat dhe rregulloret për financimin publik (financimi OSHC-të duhet të jetë në dobi të publikut, dhe jo komercial); (B) Financimi nga Bashkimi Evropian dhe institucione të tjera shumëpalëshe nuk duhet të disbursohet përmes qeverive të kombëtare ; (C) Donatorët duhet të ofrojnë një pjesë më të madhe financimi për programet e mirëqeverisjes të realizuara në bashkëpunim mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike . Këto programe duhet të kenë kërkesa të qarta kundër kapjes së OShC-ve nga interesa të veçanta. Arritja e ndikimit në fushën e OSHC-ve kërkon një perspektivë afatgjatë (10 vjet e më shumë) dhe përkushtim të qëndrueshëm.

KAPITULLI 3. PËRFORCIMI I KAPACITETEVE TË OSHC-VE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN

3.1. BASHKËPUNIMI MES OSHC-VE DHE POLITIKËBËRËSVE

Organizatat e shoqërisë civile kombëtare dhe ato të bazës që specializohen në masat antikorrupsion duhet të jenë në gjendje të identifikojnë njëri-tjetrin dhe të bashkojnë forcat në mënyrë që të përçojnë mesazhet e tyre për rritjen e ndërgjegjësimit dhe rëndësisë së luftës kundër korrupsionit në mënyrën më eficiente dhe efektive. Kjo duhet të përfshijë të kuptuarit e fushave të lidhura me çështje të tilla si krimi i organizuar, ekonomia e fshehtë, mirëqeverisja, qeverisja e hapur, etj. Duke bashkëpunuar dhe ndërtuar kornizat institucionale, mund të krijohet një mbështetje e masave antikorrupsion. Bashkëpunimi në këtë mënyrë rezulton në transparencë, llogaridhënie dhe efektivitetit të përmirësuar për shkak të axhendës për veprim për të cilën është rënë dakord. Kjo mund të zbatohet duke ndryshuar strukturën apo “modus operandi-n” të brendshëm të OSHC-ve në mënyrë që të rrisin hapjen e tyre dhe, si pasojë, ndikimet e tyre përtej kufijve. Bashkëpunimi do të rrisë kapitalin social së bashku me lidhjet e komunitetit,⁷ duke kontribuar kështu në një shoqëri dinamike civile në Evropën Juglindore, që është e aftë të marrë pjesë në debate publike dhe të ndikojë në politika dhe në procesin e vendimmarrjes në fushën e antikorrupsionit dhe mirëqeverisjes.

Aleancat që synojnë ndryshime të politikave duhet të synojnë edhe ngritjen e fuqisë së tyre dhe efektivitetit të ndikimit të tyre në politikëbërje. Për të ndërtuar aleanca të forta, efektive dhe të shëndosha, së pari, dikush duhet të ndërmarrë iniciativa, dhe së dyti, duhet të ketë të tjerë që dëshirojnë të i bashkangjiten përpjekjeve. Ndërtimi i aleancave dhe menaxhimi i tyre do të thotë punë si në përmbajtjen dhe në bashkëpunim në të njëjtën kohë. Kur ndodhë kjo, nisma mund të fillojë të rritet dhe do të krijojë një ambicie të përbashkët për gjetjen e mënyrave për të trajtuar korrupsionin.⁸ Në mënyrë që të gjendet më tepër sinergji dhe bashkëpunim në rajon, mund të realizohet një kategorizim i analizës së rrjetit. Kjo, në fakt, duhet të ketë për qëllim të vlerësojë nëse ekzistojnë OSHC-të tjera që kanë të njëjtën iniciativë të ndikimit në politika dhe të sigurimit të një analize solide të rrjetit të ndërtuar duke parë se sa arrin secila OSHC të angazhohet në këto nisma. Bashkëpunimi mes organizatave të shoqërisë civile kombëtare dhe të bazës është me rëndësi jetike për mundësuat një fokus më të madh në luftimin e korrupsionit në nivel qendror dhe lokal. Korrupsioni nuk mund të shpjegohet vetëm nga rrethanat kombëtare pasi një numër shkaqesh të tërë rajonit duhet të merren parasysh për të kuptuar thellësinë e korrupsionit dhe efektet e tij. Adoptimi i një strukturë horizontale do të rrisë kapacitetin e përfaqësuesve të OSHC-ve si pasojë e këtij shkëmbimi të njohurive praktike.⁹

Në këtë kontekst, është e rekomandueshme që OSHC-të vendosin një fokus të veçantë në përpjekjet e tyre për tri aktivitete kryesore: a) Zhvillimin institucional: përmirësimin e marrëdhënieve midis organizatave. b) Zhvillimin organizativ: të pasurit e aftësisë për të kuptuar se si kapaciteti i brendshëm zhvillohet për të siguruar që stafi përmirëson produktivitetin dhe performancën e vet. c) Fillimin e një "skanimit të shpejtë" për partnerë të mundshëm, duke pasë në një sy të përgjithshëm në misionin e tyre, grupet e targetuara, burimet e të ardhurave dhe donatorët kryesorë. Në mënyrë alternative organizatat mund të aksesojnë të

⁷ Kapitali Njerëzor. Cfarë është kapitali njerëzor?, OECD Insights, 2009, www.oecd.org/insights/37966934.pdf

⁸ TACSO, (2011). *Advocacy and Policy Influencing for Social Change*, p 124.

⁹ TACSO, (2011). Menaxhimi i OSHC-ve, Mjete praktike për analiza të zhvillimit organizativ ,

dhëna në nivel projektesh nga platforma interneti të tilla si 'Databaza e Projektit Antikorrupsion ERCAS'¹⁰ ose 'Toolbox Antikorrupsion'.¹¹

Pas kryerjes së këtij skanimi fillestar dhe identifikimit të një qëllimi të përbashkët, ka disa hapa që mund të ndërmerren për të krijuar një strategji efektive antikorrupsion:¹² a) caktimi i normave të integritetit. b) monitorimi i normave duke përdorur armë institucionale si Akti i Lirisë së Informacionit (FOIA), dhe c) informimi i publikut. Pas përfundimit të periudhës së monitorimit, të fillohen fushatat e ekspozimit dhe aktivitetet emërtuese dhe turpëruese, të cilat duhet të shtyhen në qendër të vëmendjes së medias dhe gjithashtu drejtpërsëdrejti te qytetarët (fletushka, fushata informuese derë më derë etj).

Në trajtimin e ngurrimit të qytetarëve dhe kompanive private për tu angazhuar në aktivitetet antikorrupsion, OSHC-të duhet të japin shembuj për veprim, të tillë si shembuj të aleancave të biznesit antikorrupsion të suksesshme, dhe madje edhe të inkurajojnë mpiksjen e grupeve të tilla. Gjithashtu, është e dobishme dhënia e shembujve të sjelljes dhe/ose informacionit të përshtatshëm për qytetarët e thjeshtë, të cilët shprehen se nuk dinë si të reagojnë në një situatë korrupsioni. Në vazhdim, për të luftuar skepticizmin në lidhje me aktivitetin antikorrupsion të OSHC-ve, është i nevojshëm ofrimi i një ndjekjeje konkrete të tillë si monitorimi i vazhdueshëm dhe zbulimi i mediave, përfshirja me autoritetet, sigurimi i reagimeve të qytetarëve etj.¹³

3.2. RRIJJA E TRANSPARENCËS, LLOGARIDHËNIES DHE LEGJITIMITIT TË OSHC-VE

Efektiviteti i OSHC-ve në adresimin e çështjeve të mirëqeverisjes publike në rajon varet në një masë të madhe në kapacitetin e tyre për të mbajtur qeverisjen e tyre në rregull. Ata duhet të sigurojnë vetë vetë-rregullimin e tyre duke miratuar kodet të sjelljes. OSHC-të duhet të jenë gjithashtu në gjendje të kuptojnë më mirë rëndësinë e të qenit më transparente dhe të përgjegjshme.

Rreziku i kapjes së OSHC-ve nga interesa të veçanta, zyrtarë publikë apo politikanë të zgjedhur të korruptuar buron nga mundësia për të shfrytëzuar një numër dobësish të sektorit jo-fitimprurës në rajon¹⁴ :

- mungesa e procedurave të detyrueshme të transparencës;
- pajtueshmëria joefektive me rregulloret financiare;
- mungesa e një kulture auditimi;
- niveli i ulët i vetë-rregullimit dhe koordinimit të përpjekjeve.

¹⁰ Qendra Evropiane për antikorrupsion dhe ndërtim të shtetit (ERCAS) Databaza për projektin antikorrupsion: http://www.againstcorruption.eu/?post_type=projects

¹¹ Qendra Evropiane për antikorrupsion dhe ndërtim të shteti [ase](#)
Këto hapa për një strategji efektive kundër korrupsionit janë përdorur nga Shoqëria Akademike Rumune në inicimin dhe menaxhimin e Koalicionit për Parlament të Pastër, një aleancë të OSHC-ve të formuar përpara zgjedhjeve lokale dhe parlamentare të vitit 2004 në Rumani. Iniciativa u përmend si shembull i praktikës së mirë në Antikorrupsion e Bankës Botërore në Manualin tranzicionit dhe u miratua nga disa OSHC në Ballkanin Perëndimor dhe rajonin e Detit të Zi. Source: <http://sar.org.ro/en/romania-exporta-coalitia-pentru-un-parlament-curat-in-balcani/>

¹³ Antikorrupsioni 'Toolbox' ishte një projekt i iniciuar nga Shoqata Akademike Rumune dhe vazhdoi nga

¹⁴ Qendra e Kërkimeve Evropiane për Anti-korrupsion dhe ndërtimi të shtetit- (ERCAS).
Center for the Study of Democracy, (2013). Anti-Corruption Policies against State Capture, p. 74.

Për pasojë, lufta kundër kapjes së shoqërisë civile si pjesë e përpjekjeve kombëtare antikorrupsion në Evropën Juglindore duhet të jetë në krye të axhendës së reformave në rajon. Edhe pse OSHC-të ndryshojnë në terma të madhësisë, buxheteve dhe burimeve të financimit, është e këshillueshme për të gjithë ato që të përpiqen të japin një shembull të transparencës të mirë, në atë masë që kapacitetet e tyre financiare dhe menaxhuese e lejojnë - t'i nënshtrohen auditimit të rregullt, publikimit të pasqyrave financiare, procedurave të qarta dhe transparente të qeverisjes së korporatave, dhe masave kundër kapjes nga interesa të veçanta.

OSHC-të mund të promovojnë transparencën duke përditësuar faqet e tyre zyrtare të internetit. Kjo mund të përmirësojë saktësinë e të dhënave, të tilla si të dhënat financiare, raportet vjetore dhe financimin. Ato më pas mund të jenë në kontakt me ofrues të vlerësimeve të jashtme, të tilla si Transparify,¹⁵ e cila ofron renditje botërore të transparencës financiare të organizatave të mëdha. Duke vepruar kështu, OSHC-të do të jetë në gjendje të shfaqen ndërkombëtarisht si organizata të cilat marrin vlerësim nga publikimi i informacionit të tillë si financimi dhe projektet.¹⁶

3.3. SINERGJITË DHE BASHKËPUNIMI MIDIS OSHC-VE

Organizatave të shoqërisë civile mund të përdorin "zinxhirët e influencës", për të bashkëpunuar me OSHC-të e tjera, si dhe me publikun e gjerë, duke shpërndarë në këtë formë mesazhin në mënyrë efektive.¹⁷ Rëndësi duhet t'i jepet identifikimit të OSHC-ve me të njëjtat objektiva të ndikimit për politika, si edhe përdorimit të bashkëpunimit për të rritur sferën e influencës përmes rrjetit të përbashkët, lobimit, fushatave, edukimit dhe ndërgjegjësimet. Prezantimet në eventet e jashtme, duke shkruar përmbledhje të përbashkëta të politikave, përmbledhje për mediat, publikime një faqëshe, të kombinuara me mesazhe të synuara, artikuj në media, intervista dhe prodhimet e reja të medias, të tilla si infografikët apo videografikët duhet të bazohen në bashkëpunimin e OSHC-ve për të rritur llogjitimitetin e rekomandimeve politike. Nëse i kushtohet vëmendje e barabartë përmbajtjes dhe marrëdhënieve në të njëjtën kohë, nisma mund të fillojë të rritet dhe të krijojë një ambicie të përbashkët që synon gjetjen e mënyrave për të trajtuar korrupsionin.

3.4. TË PUNOSH ME GAZETARË INVESTIGATIVË DHE TË KESH NJË PRANI TË SUKSESSHME NË MEDIAT SOCIALE

Zhvillimi i kontakteve dhe marrëdhënieve të drejtpërdrejta midis organizatave të shoqërisë civile dhe gazetarëve investigativë është një element shumë i rëndësishëm për suksesin e përpjekjeve të OSHC-ve në luftën kundër korrupsionit. OSHC-të mbi të gjitha duhet të fillojnë të afrojnë gazetarët me përvojë të përshtatshme, që kanë shkruar më parë artikuj mbi tema të ngjashme. OSHC-të duhet të sigurojnë informacion specifik për gazetarët, dhe jo të presin që ata të marrin informacion të rëndësishëm nga prezantimet apo eventet e përgjithshme.

Sigurimi i një komunikimi të brendshëm efektiv do të rezultojë në anëtarë stafi të angazhuar dhe kjo më pas minimizon gjasat që një anëtar stafi të japë citime të pasakta ose potencialisht të dëmshme për një gazetar. Në hartimin e një raporti, kini parasysh se gazetarët dhe krijuesit e politikave përqendrohen në përmbledhjen ekzekutive, kështu që ajo duhet të nxjerrë më në pah gjetjet dhe

¹⁵ Transparify website: <http://www.transparify.org/get-five/>

¹⁶ Three SELDI members have been awarded five stars by Transparify in 2015 and 2016.

¹⁷ Advocacy and Policy Influencing for Social Change, TACSO, 2011, http://www.tacso.org/doc/doc_manual_5.pdf

rekomandimet kryesore. Ekipi i komunikimit mund të zhvillojë një sërë mesazhesh kyçe standarde për tu përfshirë në strategjinë kryesore të komunikimit të OSHC-së, duke përforcuar më tej rrjetin kryesor të marrëdhënieve. Për më tepër, një prani e suksesshme në internet mund të rrisë rolin e një OSHC-së në ngritjen e kapaciteteve dhe avokimit. Media sociale është mishëruar nga kanale të ndryshme të mjeteve dinamike online që përfshijnë katër tema kryesore. Këto janë rrjetet (Facebook, LinkedIn), blogjet (Wordpress, Blogger), shpërndarjet e videove (You Tube, Vimeo) dhe shpërndarjet e fotove (Flickr, Pinterest). Përmes tyre, OSHC-të mund tu sigurojnë qytetarëve mesazhe të shkurtra, të thjeshta, tërheqëse në pamje dhe pjesë informacioni të vlefshëm, një aktivitet i cili mund të nxisë kërkesën e qytetarëve për më shumë transparencë dhe më shumë angazhim në shoqëri.

Aspekti më i rëndësishëm në politikën e mediave sociale dhe strategjisë është, që të ofrojë mesazhe të shpeshta të postuara rregullisht, nëse është nevoja edhe të përsëritura dhe të ndjekura me zhvillimet e fundit. Politikat e mediave sociale dhe qëllimet e strategjisë mund të përfshijnë:

- zgjerimin e qasjes dhe ndërgjegjësimit të shërbimeve për komunitetin online.
- krijimin e komuniteteve në rrjet për mbështetje dhe shkëmbim informacioni.
- lidhjen e aktivizmit online me aktivizmin offline për të rritur ndikimin e përpjekjeve të avokimit.
- përdorimin si avantazh të mediave sociale për mbledhjen e fondeve.

Me qëllim zbatimin e strategjisë të përpunuar në mënyrë efektive është i nevojshëm përcaktimi i audiencës, duke përfshirë edhe gjuhën e komunikimit duhet modifikuar në përputhje me rrethanat. OSHC-të, duke përfshirë edhe rastin e fushës së antikorrupsionit, kanë tendencë të përdorin gjuhën e ekspertëve, e cila nuk është lehtësisht e kapshme për audiencën. Gjatë komunikimit me qytetarët, ata duhet të përpiqen të përdorin gjuhën e "njerëzve të zakonshëm". Duke përcaktuar këtë, aspekti kyç për një prani të suksesshme në mediat sociale është përgatitja e një përmbajtje me cilësi të lartë.

Udhëzimet e mëposhtme duhet të merren në konsideratë:

- Përdorni figurat, grafikët, info-grafikët dhe afatet kohore për të shpjeguar çështjen;
- Zhvilloni përmbajtje të përshtatshme dhe dinamike për të frymëzuar audiencën për të lexuar dhe për të shpërndarë;
- Shpërndani statistikën përkatëse apo citime të shkurtra por të fuqishme dhe kurdoherë që është e mundur, bashkëngjisni tekstin në imazhe ose video në mënyrë që të ketë një ndikim më të madh.
- Testoni versione të ndryshme të një postimi fillestar në një fushatë;
- Përsëriteni një postim të suksesshëm që fiton angazhimin të mirë;
- Jini spontan dhe përcillni entuziazmin tuaj për punën tuaj, duke kapur momentin e duhur për të prezantuar informacion të ri.

Ka guida të shumta në internet të cilat mund të ndihmojnë OSHC-të në lundrimin përmes mediave sociale duke qenë se ato ofrojnë sugjerime nga koha e duhur për të postuar deri në mënyrën më të

Ka guida të shumta në internet të cilat mund të ndihmojnë OSHC-të në lundrimin përmes mediave sociale duke qenë se ato ofrojnë sugjerime nga koha e duhur për të postuar deri në mënyrën më të

mirë të krijuar një postim.¹⁸ Për më tepër, OSHC-të duhet të diskutojnë mbi pozicionimin e markës së tyre, psh për simbolin e organizatës në mënyrë që të lidhë përpjekjet e tyre me identitetin OSHC-së.¹⁹

¹⁸ For more information, see websites such as PR Daily, <http://www.prdaily.com/Main/Articles/11021.aspx#> and http://www.prdaily.com/Main/Articles/Stepbystep_SEO_guide_for_YouTube_videos_11124.aspx

¹⁹ Social Networking: A Guide to Strengthening Civil Society Through Social Media, USAID, 2014, <http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1866/SMGuide4CSO.pdf>

KAPITULLI 4. TABELA E QËNDRUESHMËRISË DHE PLANIFIKIMIT STRATEGJIK NË VITIN 2020

Strategjia aktuale e Shoqërisë Civile dhe Programi i Përbashkët Strategjik është bazuar në shembullin praktik të operacionit SELDI në periudhën 2012-2016. Ajo synon të prezantojë mundësitë për vazhdimin e nismave antikorrupsion dhe rrjeteve që veprojnë në Evropën Juglindore, duke u bazuar në shembullin e SELDI-t. Ky plan thekson gjithashtu potencialin për përdorimin e mëtejshëm të aktiviteteve të SELDI-t, dhe identifikon mundësitë për shërbime të ardhme.

Planifikimi i Qëndrueshëm dhe Strategjik i SELDI-t deri në 2020

<p>1. Grupet e synuara (klientët/ përfituesit e produkteve dhe shërbimeve të iniciativave kundër korrupsionit)</p>	<p>Grupet e synuara</p> <ul style="list-style-type: none"> • Organet qeveritare, duke përfshirë: • Komisionet e Antikorrupsionit dhe parandalimit të konfliktit të interesit në Kuvend • Ministrinë e Drejtësisë, Ekonomisë, Financës, Politikës Sociale, Punës, Administratës Publike etj • Agjencitë Antikorrupsion • Gjyqësori dhe prokuroria • Agjencitë Kombëtare të të Ardhurave, Agjencitë Doganore, Agjencitë e Sigurisë Ushqimore, Ndërtimit dhe Mjekësisë dhe Drejtoritë • Komisionet e Mbikëqyrjes Financiare dhe Komisionet ose Agjencitë për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Mbrojtjen e Mjedisit, Bankat Qendrore, Komisionet e Rregulloreve të Komunikimit, Zyra e Prokurimit Publik etj • Inspektoratet e taksave, të ardhurave, të punës, shëndetit, energjisë, ujit dhe inspektoratet e tjera • Policia financiare 	<p>Grupet e synuara (vazhdim)</p> <ul style="list-style-type: none"> • OSHC-të dhe shoqatat, duke përfshirë: - Shërbimi ndaj komunitetit • Fondacionet, sponsorizimi i programeve dhe eventet • ‘Think-tanks’ apo institutet e politikave (duke kryer kërkim dhe advokimit) • Organizatat bamirëse • Mbrojtja e grupeve të cënueshme, mjedisit dhe organizata të lidhura me tema të lidhura - Shërbimi ndaj anëtarëve psh shoqatat e biznesit, tregtisë dhe industrisë - Të përcaktuar nga mbulimi gjeografik • ndërkombëtar • kombëtar • organizata bazë - Kërkuesit dhe institucionet e tyre përkatëse arsimore - Bizneset dhe sektori privat <p>Nevojat e grupeve të identifikuara</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacione analitike dhe statistikore • Rekomandimet e politikave • Analiza e rrezikut të korrupsionit • Trajnimi dhe ndërgjegjësimi
<p>1. Përshkrimi i produktit</p>	<p>Produktet aktuale të iniciativës së SELDI-t</p> <p>Raundet dyjehëzore të Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit, duke përfshirë:</p>	<p>Produktet e ardhshme / të pritshme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i Implementimit të Politikave Antikorrupsion (MACPI) - një mjet që mat rreziqet e korrupsionit në nivel të institucionit individual

	<ul style="list-style-type: none"> • Studimi i popullsisë • Raporti Rajonal i Antikorrupsionit • Raportet Kombëtare të Vlerësimit të Korrupsionit • Analiza të shkurtra dhe përmbledhje të politikave të orientuara në fusha specifike • Rekomandimet e politikave dhe fushatat avokuese për qeveritë vendore • Reagimi dhe rishikimi i dokumenteve të politikave nga Bordi Këshillimor Ndërkombëtar i SELDI-t • Forumi Vjetor Rajonal Antikorrupsion • Faqet e internetit dhe media sociale • Buletini informativ • Komunikimet për shtyp dhe njoftimet e mediave 	<ul style="list-style-type: none"> • Analizat e bëra posaçërisht për rrezikun e korrupsionit • Monitorimi i mediave për Korrupsionin • Mbështetje për OSHC-të e bazës për përgatitjen e aplikimeve për projekte • Aksesit në bazat e të dhënave statistiko-re, duke përfshirë të dhënat e studimit të korrupsionit të SELDI-t • Hartimi i Manualeve dhe Guidave Antikorrupsion • Bashkëpunimi me gazetarët investigativë • Ndërtimi i databazave të formatit të hapur në lidhje me sektorët e nën-studiuar / nën-trajtuar (IT, energji, etj)
<p>3. Partneriteti / sinergjitë për veprim të përbashkët</p>	<p>Sinergjitë dhe veprimet e përbashkëta të mundshme mund të kërkohen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • OSHC-të tjera, duke zbatuar veprime të ngjashme në fushën e mirëqeverisjes dhe të antikorrupsionit • Iniciativat rajonale dhe ndërkombëtare / organizatat ndërkombëtare • Institucionet Qeveritare të specializuara në antikorrupsion • Bizneset dhe korporatat • Institucionet Kërkimore • Kërkuesit individuale • Mediat dhe gazetarët investigativë <p>Lidhje me rrjetet e tjera FPA/IPA që punojnë në tema të ngjashme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politikat e Energjisë së Qëndrueshme të Evropës Juglindore (SEE Change Net) • Avokimi për Qeverisje të Hapur • Drejt Mekanizmave Efiçente të Prokurimit Publik në Vendet Kandidate (potenciale) të BE-së • Observatori i Mediave të Evropës Juglindore etj 	<p>Sinergjitë ekzistuese me projektet aktuale</p> <ul style="list-style-type: none"> • ANTICORRP (http://anticorpp.eu/), një projekt kërkimor antikorrupsion në shkallë të madhe i financuar nga Programi I Shtatë në kuadër i KE-së. Ky projekt përfshin tri partnerë të SELDI-t. • Programi Maqedonas Antikorrupsion, i financuar nga USAID-i, i cili përfshin tri partnerë të SELDI-t. • TACSO, financuar nga Komision Evropian, Drejtoria e Përgjithshme NEAR. <p>Sinergjitë e mundshme me organizatat ndërkombëtare</p> <ul style="list-style-type: none"> • OLAF, FRONTEX; dhe Grupi i Ekspertëve të BE-së për Korrupsionin etj Këshilli i Evropës; GRECO; UNDP dhe UNODC; RAI, CEI, SEECIP; Transparency International; Banka Botërore dhe EBRD, Transparify. • Organizatat zbatuese të Strategjisë së Këshillit të Evropës për Inovacionin dhe • Mirëqeverisje në nivel lokal dhe të Klasifikimit Evropian të Ekselencës në Qeverisje.

<p>4. Përshkrimi Financiar</p>	<p>Ndihma financiare për vazhdimin e aktiviteteve ose zhvillimin e aktiviteteve të reja mund të kërkohej nga:</p> <p>Në rend zbritës të gatishmërisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Donatorët ndërkombëtar dhe të BE-së • Qeveria kombëtare dhe qeveritë e vendeve të tjera • Bizneset dhe korporatat • Fondacionet / ojq-të e tjera • Individët 	<p>Metodat e mundshme të financimit ose angazhimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • grante ose tendera nga donatorët • tarifë anëtarësimi vjetore/mujore nga: <ul style="list-style-type: none"> - Rrjeti i brendshëm (anëtarët e iniciativës) - Rrjeti i jashtëm (organizata dhe kontribuues të tjera) - Organizatat - Individët (duke përfshirë edhe studentët) • Zhvillimi i aftësive këshilluese • Vullnetarizmi
<p>5. Rreziqet</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e kapacitetit financiar të sektorit privat dhe traditës së dhurimeve private • Antagonizmi politik, duke frenuar donacionet dhe format e tjera të mbështetjes • Kapja e shoqërisë civile dhe e mediave (krijimi i mediave dhe OSHC-ve miqësore ndaj qeverisë) • Frika e pasojave dhe përdorimi i rezultateve dhe gjetjeve për qëllime politike • Kapacitet i ulët për të mobilizuar dhe trajnuar burimet njerëzore • Mungesa e informacionit (qasja në databaza ose dokumente të politikave) 	

Burimi: Plani i Biznesit të Qëndrueshëm Eval-Inno, Nëntor 2012.

